



*Open Society Foundation for Albania
Soros Foundation*

*The concept of open society is based on the recognition
that people act on imperfect knowledge and nobody is in
possession of the ultimate truth.*

RAPORT MBI REALIZIMIT E TREGUESVE BUXHETORË TË 4- MUJORIT TË PARË

MONITORIMI I BUXHETIT 2009 – RAPORTI II

- 1. Viti 2009 dhe kuadri makro-ekonomik ne kete fillim viti.**
- 2. Analize e realizimit te treguesve fiskale per periudhen janar-prill 2009.**
- 3. Sugjerime dhe rekomandime.**

1. Viti 2009 dhe kuadri makro-ekonomik ne kete fillim viti.

Gjysma e dytë e vitit 2008 dhe fillim viti 2009 dëshmuar për një thellim të krizës globale financiare dhe shtrirjen e saj në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë reale. E nisur si një “krizë e tregut të shtëpive” ajo u shëndrrua shpejt në një krizë financiare me pasojë kolapsin e disa bankave gjigande në SHBA dhe në Europë dhe tronditjen serioze në të gjithë rendin dhe mekanizmat e sistemit botëror të ekonomisë e financave. Procesi i hapjes së tregjeve dhe integrimi ekonomik nuk mund të mos sillte shtrirjen e qëndrueshme të efekteve të krizës edhe tek vendet në zhvillim dhe ekonomitë e tranzicionit.

Perspektiva për vitin 2009 duket ende e zymtë. Ekonomia botërore do të vazhdojë të vuajë nga rënia e kërkesës, si rezultat i rënies së investimeve private dhe të tregtisë; dhe nga rritja e papunësisë. Kërkesa do të vazhdojë të bjerë edhe si rezultat i prirjes së biznesit dhe qytetarëve për një sjellje të shtrënguar ndaj shpenzimeve.

Për Europën vlerësimet e FMN janë edhe më skeptike. “Edhe në se supozojmë një mbështetje më të madhe me politika, rënia ka gjasa të vazhdojë deri në fillim të 2010” –thotë FMN në buletin “Tabloja e Zhvillimit Ekonomik për Europën”, Prill 2009. Dhe në kushtet e një rënie të vazhdueshme të kërkesës botërore as politikat me orientim eksporti nuk pritet të jenë efektive. Në vendet në tranzicion të Europës, situata është gjithashtu e turbullt. Karakteristikë e këtij grupimi është diferencimi i lartë mes vendeve të veçanta në shkallën dhe thellësinë e prekjës nga kriza. Rol të madh këtu luan suksesi i vendit në ruajtjen e treguesve makroekonomikë. Vendet me inflacion dhe deficit të llogarisë korrente më të ulët si dhe vendet me një varësi më të vogël nga kapitali bankar ndërkombëtar, ja kanë dalë më mirë deri tani. “Indikatorët e “mbinxehjes” ekonomike si deficit i lartë i llogarisë korrente, rritja e shpejtë e kreditimit dhe inflacioni më i lëshuar, shfaqen më dukshëm në vendet më të prekura nga kriza” –thotë raporti i sipërpërmendur.

Ndërkohë autoritetet publike në shkallë botërore, kanë krijuar stimuj të jashtëzakonshëm fiskalë dhe monetarë për t'iu përgjigjur rreziqeve afat të shkurtër dhe afat-mesëm. Në vështrim afat-mesëm, pritjet që masa të tilla, të rivendosin besimin tek tregjet financiare dhe të rikthejnë normalitetin në funksionimin e tyre, në mënyrë që ato të rifillojnë procesin e ndërmjetësimit financiar. Ky proces korrektimi i vështirë nuk pritjet sidoqoftë të japë efekte rigjallëruese deri në fund të 2009

Shkurt sot është e gjithëpranuar se vetëm në 2010 shpresohet që ekonomia botërore t'i rikthehet rritjes dhe gradualitetit.

Për vitin 2009, qeveria parashikon realizimin e deficitit buxhetor në masën 4.2 për qind të PBB. Pjesa më madhe e tij pritjet të financohet nga burime të huaja duke nënkuptuar një fluks relativisht të madh hyrjesh valutore në formën e financimit të huaj.

Në lidhje me zhvillimet në sektorin real të ekonomisë, në terma nominalë u ruajt prirja e rritjes me ritme të kënaqshme edhe pse larg atyre të shpallura përmes deklaratave qeveritare (rritja dyshifrore). Kështu rritja e PBB nga FMN raportohet në nivelin 6.8% (autoritetet vazhdojnë të japin shifra kontradiktore mbi këtë tregues). Rritja e aktivitetit vjen kryesisht nga sektori i ndërtimit – i cili në fakt dominohet nga angazhimi në rrugën Durrës-Kukës -dhe sektori i shërbimeve me rreth 15 për qind. Rritje të kënaqshme dëshmojnë edhe sektori i transportit dhe ai i tregtisë.

Niveli i punësimit mbetet relativisht i mirë, në se i besojmë raportimit zyrtar të treguesit të papunësisë prej 12,6%. Ndërkohë çështja e saktësisë dhe seriozitetit të përpunimit e shpalljes së këtij treguesi mbetet një debat i hapur, për shkak të kritereve metodologjike mjaft larg realitetit. Vështirësitë e bizneseve dhe zhvillimet e ekonomisë reale gjatë vitit 2009, do të ndikojnë në nivelin e punësimit duke kufizuar rritjen e të ardhurave të familjeve. Për këtë arsye, edhe treguesi i besimit të konsumatorit për tremujorin e fundit të vitit 2008, paraqitet në rënie dhe nën mesataren e tij historike. Në veçanti, pritjet e konsumatorëve për vitin 2009 tregojnë për një rënie të punëzënies, duke qenë kështu plotësuese me pritjet e bizneseve. Pritjet më të ulëta për kushtet ekonomike gjatë këtij viti, mund të ndikojnë sjelljen e biznesit dhe të konsumatorit në drejtim të uljes së investimeve dhe të konsumit. Ngadalësimi i ekonomisë ndërkombëtare, rënia e çmimeve të lëndëve të para të energjisë dhe të produkteve ushqimore, si edhe pritjet për një rënie të kërkesës nga ana e sektorit real të ekonomisë sonë, pritjet të ulin vëllimin e tregtisë dhe të mbajnë nën kontroll deficitin e bilancit tregtar për pjesën më të madhe të vitit 2009

Zhvillimet botërore në tremujorin e fundit të vitit, rriten ndjeshmërinë e publikut ndaj sigurisë së kursimeve. Kjo situatë u zbut në fundviti dhe në muajt e parë 2009, si rezultat i ndërveprimit të disa faktorëve. Më i rëndësishmi (sipas Bankës së Shqipërisë ishte mirëkapitalizimi dhe kapaciteti likuid i sistemit tonë bankar. Ne do të shtonim këtu se rol pozitiv luajti edhe qëndrimi konstruktiv dhe i përgjegjshëm i politikës sidomos i opozitës, dhe pjekuria e publikut shqiptar i cili duket ka një vetëdijë të formuar tashmë mbi pasojat e një paniku në këtë fushë. Një meritë të madhe në kapërcimin e kësaj ndjeshmërie ka padyshim edhe media si dhe shoqëria civile dhe ekspertët e pavarur, analistë të ekonomisë.

Viti 2009, në kushtet e thellimit të mëtejshëm të krizës ndërkombëtare, do ta përballë ekonominë shqiptare me disa sfida të reja. Rritja ekonomike vjetore pritjet të jetë në nivele recessioni, pra jo më e lartë se sa 1%.

Kjo shtron nevojën e disa masave:

Së pari, kjo kërkon një vlerësim realist të situatës nga ana e qeverisë dhe institucioneve vendimmarrëse. E prirur fort drejt një politizimi të tejskajshëm qeveria përpiqet ende të mbajë pozicione euforike e naiviteti duke ri-deklaruar imunizim të ekonomisë shqiptare nga goditja e krizës. Për këtë ajo përdor dy rrugë; ose një konfuzion të vetëdijshëm me statistikat zyrtare, ose referimin e njëanshëm mediatik vetëm në burime që nënvizojnë hapat pozitive të qeverisjes. Këto të fundit gjithsesi nuk lexohen në tërësinë e tyre, por vetëm duke nënvizuar sukseset.

Rast tipik është referimi kohët e fundit i një vlerësimi vjetor të kryer nga shoqëria e vlerësimeve Moody's ku ekonomia shqiptare renditet në kategorinë e një "tabloje stabil". Pa dyshim kjo ngrihet mbi analizën e disa politikave liberalizuese, lehtësuese e të anti-informalitetit të ndërmarra në këto vite. Por në se lexohet në mënyrë të balancuar, edhe ky vlerësim shtron nevojën e mënjanimi të euforisë dhe rritjes së kujdesit.

Sepse si "faktorë suksesi" atje rreshtohen edhe tregues që në thelb flasin për prapambetje dhe jo zhvillim, siç është "mungesa e sofistikimit të sektorit financiar" shqiptar –përfshi edhe mosintegrimin e tij me tregjet e botës së zhvilluar, përmirësimi i sektorit elektrik "si rezultat i përmirësimit të situatës hidrike", etj.

Nga ana tjetër po ky vlerësim suksesi relativ e të përgjithshëm, rreshton dukshëm edhe drejtime të një risku të qartë ndaj këtij stabiliteti –në se nuk merren masat e duhura.

Kështu investimet kolosale në një projekt të vetëm (segmenti Rrëshen-Kalimash) vërtet përbën një përmirësim të ardhshëm të klimës së biznesit e investimeve, por ama përbën një tronditje të qartë për llogarinë fiskale kombëtare për rrjedhojë kërkon një vëmendje të shtuar në ruajtjen nga një deficit dhe borxh i shtuar befas.

Po kështu, Moody's vlerëson eksplicit, si vërejtje dhe sfida për vendimmarrësit edhe nevojën për:

- (i) kompensim të rënies së remitancave dhe përmirësim deficitit të llogarisë korente
- (ii) forcim të institucioneve dhe rritje të parashikueshmërisë së politikave që ndiqen
- (iii) zgjerim të bazës së eksporteve dhe ulja e riskut të bilancit të pagesave.

Së dyti, kërkohet një vëmendje e posaçme ndaj paralajmërimeve të institucioneve të pavarura lidhur me shpenzimet buxhetore:

Kështu në zbatim të rekomandimeve të BSH, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar ecurisë së shpenzimeve kapitale të cilat u rritën me rreth 3 pikë përqindje në raport me PBB, diktuar nga objektivat për investime në projektet e rëndësishme të infrastrukturës.

Në një kohë kur ekonomia e vendit mund të ngadalësojë ritmet e rritjes, poshtë parashikimeve të mëparshme dhe kur kërkesa e sektorit bankar për letra me vlerë të qeverisë rezulton në rënie, është e nevojshme të përgatiten mënyra alternative të veprimit. Në rast se të dy rreziqet e sipërpërmendura do të materializohen, atëherë do të ballafaqohemi me një situatë më të vështirë përse i takon financimit të shpenzimeve. Për këtë arsye, vlerësojmë se është e nevojshme ristrukturimi i shpenzimeve në përputhje me përparësitë dhe ecurinë e të ardhurave fiskale, përgjatë vitit.

Shpërndarja sa më e njëtrajtshme në kohë e shpenzimeve të pritshme, do t'i kontribuojë më mirë ekuilibrave të vendosur në tregun financiar dhe posaçërisht në tregun ndërbankar, ku ecuria e huamarrjes dhe e shpenzimeve publike, kanë një ndikim të konsiderueshëm.

2. Analiza e realizimit të treguesve fiskale për periudhën janar-prill 2009.

2.1 Vleresime të përgjithshme rreth situatës buxhetore Janar-Prill 2009.

Mbeshtetur në të dhënat paraprake të thesarit, rezulton se situata buxhetore gjatë muajit Prill, në krahasim me 3 mujorin e parë të vitit 2009, është përkeqësuar duke shënuar një thellim të deficitit buxhetor. Tejkalimi i deficitit buxhetor për këtë periudhë është pasojë e:

- A. Tejkalimit të ndjeshëm të shpenzimeve publike në këtë prag zgjedhesh për kundrejt objektivave të 4 mujorit të parë të vitit 2009 të vendosura nga vete Qeveria.
- B. Performanca e ulët e mbledhjes së të ardhurave të buxhetit të shtetit për kundrejt planit të kësaj periudhe. Vecanerisht në të ardhurat tatimore.

Sipas të dhënave të thesarit, deficitin buxhetor në fund të 4 mujorit të parë të vitit 2009, është tejkualuar me rreth 6.1 miliard leke ose me 78.9 %, me shumë se objektivat e kësaj periudhe. Deficitin i brendshëm është tejkualuar me rreth 1.3 miliard leke ose 120.5 % për kundrejt planit.

1. Të ardhurat e buxhetit të shtetit për 4 mujorin e parë të vitit 2009 janë realizuar vetëm 96%, ose ndryshe kanë krijuar me një diferencë prej 4.059 miliard leke. Nderkohe që të ardhurat tatimore janë realizuar vetëm 95% ose me një mosrealizim prej 4.4 miliard leke.
 - Po të referohemi të ardhurave që administrohen nga administrata tatimore e doganore, objektivat për këtë periudhë, janë realizuar vetëm 94% ose me një mosrealizim në krahasim me objektivat e planit, prej 3.4 miliard leke. Sipas të dhënave nga administrata tatimore pothuajse të gjithë llojet e tatimeve rezultojnë me mosrealizim, me përjashtim të tatimit mbi të ardhurat personale dhe takses nacionale. Nderkohe që tatimet me kontribut me të madh në buxhet si TVSH dhe Akciza, janë nën nivelet e objektivave të periudhës, kështu :
 - A) TVSH ...93 % ose - 2.4 miliard leke
 - B) Akciza ...76 % ose - 2.8 miliard leke
 - Nderkohe, organet e pushtetit vendor, kanë edhe ato një deficit në të ardhurat prej 1.2 miliard leke ose realizim prej 80% i objektivave të 4 mujorit të parë të vitit. Kontributin kryesor në mosrealizimin e të ardhurave të organeve të qeverisjes vendore për këtë periudhë e ka patur zeri tatimi mbi pasurinë, i pasuar nga taksa lokale. Këto zera janë realizuar respektivisht 55 dhe 77 % ose 564 dhe 931 milion leke.
2. Për sa i përket programit të shpenzimeve, për herë të parë pas 1996 programi i shpenzimeve, për periudhën Janar – Prill 2009 është tejkualuar. Shpenzimet e kësaj periudhe janë

mbirealizuar ne vleren 2.130 miliard leke duke shenuar 102% te planit , kryesisht si pasoje e:

- Tejkalimit te shpenzimeve personelit me rreth 1.922 milion leke duke shenuar realizim te planit ne nivelin 111%.
- Realizimit te 8.4 miliard lek me shume se plani ne zerin shpenzimet kapitale, gjithsej 136 % te zerit fillestar (5.1 miliard leke jane shpenzuar vetem ne rrugen Durres –Kukes)

Analiza e treguesve te buxhetit dhe tendencat e pergjitheshme e buxhetit te shtetit, ne kete prag fushate, tregon se ka disbalancime te theksuara ne realizimin e shpenzimeve duke renduar keshtu 6 mujorin e pare me shpenzime dhe duke ulur kerkesen dhe performancen e administrates tatimore ne teresi. Kjo shtate i shfaq pasojat ne rritjen e pakontrolluar te deficitit dhe perdorimin e instrumentit te borxhit (me interesa shume te larta, krahasuar me tregun) per financimin e disa “aktiviteteve”. Rritja e interesave te bonove te thesarit, por edhe interesat e larte te kredive, do te rendojne me tej interesat e borxhit ne vitet qe pasojne, duke kufizuar edhe hapsirat per shpenzime te tjera “produktive”

2.2 Realizimi i te ardhurave fiskale.

Ne gjykojme se ne mos realizimin e objektivave fiskale per 4 mujorin e pare kane ndikuar nje sere faktoresh, te cilet po i rendisim si me poshte :

1. Renia e ritmeve te rritjes ekonomike - Megjithese nga autoritetet po injorohet ky faktor, ne kundersizim te plote me parashikimin e FMN se rritja ekonomike nuk do ta kaloje nivelin e 0.4% kete vit, ne mendojme se ky faktor ka ndikuar drejt per drejt ne renien e te ardhurave tatimore. Keto te ardhura, per mendimin tone, duhen rivleresuar me realizem, me synimin e rivendosjes se balances midis shpenzimeve dhe burimeve financiare, dhe ruajtjen e deficitit buxhetor ne parametrat e percaktuar nga ligji i buxhetit per vitin 2009. Shmangia ne maksimum e perdorimit te instrumentit te borxhit per financimin e deficitit duhet te jete objektiv me vete i autoriteteve. Ndikimi i renies se ritmit te rritjes ekonomike ndihet vecanerisht ne rezultatin e arketimeve nga Tatimi i Vleres se Shtuar dhe Akcizes. Sipas te dhenave te thesarit, mbledhja e ketyre zerave eshte realizuar perkundrejt objektivave te vendosur nga vete strukturat e Ministrise se Financave ne nivelet respektive 94 dhe 76%. Renia e importeve reflekton mbi rezultatet e arketimit te te ardhurave nga akciza, e cila megjithe rritjen e cmimit te karburanteve, ne tregun boterore,por edhe te produkteve te tjera eshte larg objektivave. Mesa duket kjo eshte edhe arsyeja e ndryshimit te shpeshte te objektivave ligjore (2 here gjate vitit 2008) ne arketimin e te ardhurave nga aplikimi i Akcizes
2. Pergjithesisht ne prag te zgjedhjeve, vihet re nje tkurrje e aktivitetit te biznesit privat, ne pritje te zhvillimeve politike si dhe ne pritje te politikave te reja fiskale, qe do te ndermarre maxhoranca produkt i zgjedhjeve te 28 qershorit 2009.
3. Administrata fiskale, edhe per shkak te levizjeve te shpeshta ne personel dhe paqendrushmerise afatgjate, ka ”zbutur“ qendrimin ndaj biznesit dhe ka ulur intensitetin e punes ne kete prag fushate.

Duke iu referuar strukturese se realizimit te te ardhurave fiskale vihet re se performanca e dy taksave kryesore (TVSH + Akcize) eshte pothuaj ne te njejtat raporte kontributive si dhe vitet 2007 dhe 2008, madje pesha specifike e akcizes ne raport me te ardhurat e tjera fiskale ka rene (Shiko grafiket shoqerues me poshte).

Nderkohe vihet re se tatimi mbi te ardhurat personale qe ne vitin 2007 kontribuonte 6% te totalit te te ardhurave tatimore e doganore kontribuon ne vitin 2009 13% te te ardhurave. Ne 4 mujorin e pare te ketij viti kjo takse eshte realizuar ne masen 124%. Ne kete rast ne mendojme se ka dobesi ne perlllogaritjen dhe marrjen parasysh te variablave qe ndikojne mbi madhesine e kesaj takse sic jane pagat referuese, nr. i punonjesve i detyrueshem per nje biznes si dhe fakti se kjo takse i shtrin tashme efektet edhe ne shtresat e popullsise qe deri ishin te perjashtuar nga pagesa e tatimit mbi te ardhurat personale.

Nje problem tjetër qe evidentohet nga analiza, eshte edhe performanca e ardhurave nga Tatim i Vleres se Shtuar, qe krahasuar me te njejtën periudhe te vitit 2008, rezulton me nje rritje prej vetem 3%. Ky ritem i ulet rritjeje konformon faktin, te theksuar nga ne, se pervec te tjerave renia ekonomike ka filluar te ndjehet dhe te kete efektet e saj ne nivelin e veprimtarise ekonomike, duke u pasqyruar keshtu rradhe te pare mbi TVSH-ne. Nisur nga ky fakt dhe duke patur parasysh se kjo takse ka peshen kryesore ne te ardhurat fiskale, mendojme se nje analize e hollesishme duhet te ndermerret nga administrata fiskale per reflektuar mbi shkaqet subjektive qe kane cuar ne mosrealizimin e objektivave me synim rikuperimin e gap-it, pse jo edhe me ane te rishperndarjes se objektivave per pjesen e mbetur te vitit. E njejtë analize mund te shtrihet edhe mbi akcizen e cila ne periudhat e fundit ka patur nje performance aspak te kenaqshme, keshtu duke iu referuar arketimeve te akcizes sipas administres tatimore kemi situaten e paraqitur nga tabela me poshte:

Akciza (ne milione lek)

Nr	Emertimi	progresivisht	Ne % te planit	Muaji prill	Ne % te planit
1	Administrata tatimore	- 700	86	- 400	74
2	Administra doganore	- 2 200	70	- 700	60



Per te ilustruar sa thame me siper ne vijim gjeni te dhenat e hollesishme:



Te ardhurat e buxhetit 4 mujori i I, 2009 (ne milione lek)

nr	Emertimi	Plan	Fakt	Ndryshimi	Ne % te planit
	Totali i te ardhurave	101,659	97,600	(4,059)	96%
1	Te ardhura nga ndihma	1,357	576	(781)	42%
2	Tatime dhe dogana	68,973	65,486	(3,487)	95%
3	Te ardhura nga pushteti vendor	6,493	5,217	(1,276)	80%
4	Te ardhura te ISH dhe ISKSH	17,706	18,012	306	102%
5	Te ardhura jotatimore	7,130	8,309	1,179	117%

Te ardhurat e buxhetit nder vite (ne milione lek)

	Emertimi	2007				2008				2009			
		plan	fakt	diferenca	ne %	plan	fakt	diferenca	ne %	plan	fakt	diferenca	ne %
1	Tatim mbi vleren e shtuar	24,285	26,421	2,136	109%	30,006	32,423	2,417	108%	35,811	33,352	-2459	93%
2	Akciza	7,138	7,616	478	107%	4,850	7,305	2,455	151%	12,064	9,194	-2870	76%
3	Tatim fitimi	7,424	6,920	-504	93%	10,353	9,070	-1,283	88%	7,269	6,720	-549	92%
4	Tatim mbi te ardhurat personale	3,185	3,072	-113	96%	3,700	6,563	2,863	177%	6,922	8,596	1674	124%
5	Taksat nacionale	5,787	4,846	-941	84%	5,790	4,656	-1,134	80%	4,989	5,352	363	107%
6	taksa doganore	3,423	3,375	-48	99%	2,791	2,835	44	102%	1,918	2,282	364	119%





2.3 Realizimi i programit te shpenzimeve

Gjate periudhes Janar – Prill 2009 vihet re se shpenzimet publike jane tejkaluar me rreth 2.13 miliard leke ose rreth 2% me shume se plani. Tejkalimi i programit te shpenzimeve, eshte pasoje e tejkalimit ne zerat:

- Shpenzime personeli +1.922 milion leke ose 111%
- Shpenzime Kapitale +8.490 milion leke ose 136%
- Subvencioni +22 milion leke ose 103%

Pavarsisht se rritja e diferencuar e pagave ka qene e planifikuar ne ligjin vjetor te buxhetit, deviacionet e verejtura nga tejkalimi i fondit te pagave pertej skemes se buxhetit fillestar na shtyjne te dyshojme per ndryshim te politikave te pagave ne prag te zgjedhjeve. Megjithate kjo mund te jete edhe rezultat i perlllogaritjeve te gabuara dhe te institucionalizuara ne buxhetin e vitit 2009.

Nga ana tjetër shpenzimet kapitale, kanë patur një tejkalim të ndjeshëm prej 8.4 miliard leke, pjesa kryesore e të cilës është si pasojë e projektit të segmentit rrugor Rreshen Kalimash. Për këtë projekt, në 4 muajin e parë të këtij viti janë shpenzuar rreth 15.6 miliard leke ose 50%, të totalit të shpenzimeve kapitale parashikuar për këtë periudhë. Tejkalmi i programit të shpenzimeve kapitale në një situatë tjetër, ku të ardhurat buxhetore e vecanerisht ato tatimore të realizohen në mënyrë ritmike do të ishte i vlerësuar, por jo në rastin konkret kur është krijuar një gap nga të ardhurat tatimore dhe ku situata makroekonomike po paraqet problematikat e saj. Fakti që “pjesa e luanit” e investimeve shkon për një projekt të vetëm në shtet të theksojmë se nga autoritetet duhet të tregohet një kujdes i veçantë për kontrollin e shpenzimeve publike në përpjestim dhe në balance të drejta me burimet financiare. Përdorimi i kufizuar i instrumentit të kredise do të ishte shumë i mirepritur duke patur parasysh edhe efektet e menjehershme që mund të ketë në kufizimin e shpenzimeve publike në të ardhmen e afert për shkak të interesave të larta që gjeneron një kredi me interesa të larta, sidomos në këtë rast kur interesat do të pasqyrohen, menjëherë në buxhetin e shtetit të vitit të ardhshëm.

Ndërkohe vëhet re e njëjta dobësi kur bëhet fjalë për kostot e borxhit që edhe për këtë periudhë rezultojnë me një kursim 485 milion leke, kryesisht rezultat i parashikimeve të pasakta. Edhe në raportet të mëparshme në kemi konstatuar dhe rekomanduar përsosjen e përlogaritjeve dhe konsolidimin e database-it, zhvillim ky që krijon premisa të shëndosha për një përlogaritje të saktë të kostos së borxhit duke liruar kështu fondet të cilat mund të riadresohen për shpenzime të tjera të vlefshme.

Për sa i përket shpenzimeve operative, ato janë realizuar në nivelin 84% ose me një mosrealizim prej 1.5 miliard lekesh. Është për tu shprehur që pjesa dërrmuese e mosrealizimit të jetë rrjedhojë e kursimit të shpenzimeve administrative dhe jo atyre të mirembajtjes apo shërbimeve të tjera që lidhet me sektorë jetikë si shëndetësia dhe arsimit.

Shpenzimet për institucionet e pavarura si Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Kujdesit dhe i Sigurimit Shëndetësor rezultojnë me mosrealizim prej rreth 2 miliard leke ose 93% përkundërt planit.

Për këtë periudhë të vitit, shpenzimet për politikën sociale janë realizuar në masën 89% ose me një kursim prej 545 milion leke kryesisht si kontribut i mosrealizimit të kompesimit të ish-përndjekurve politik. Nga ana tjetër edhe kompesimi i ish-pronarëve deri në fund të prillit 2009 nuk ka ecur sipas parashikimeve duke mos përdorur asnjë pjesë të fondit prej 500 milion lek të parashikuar për këtë qëllim në 4 muajin e parë.

Fondi rezervë i Keshillit të Ministrave për këtë periudhë nuk është prekur, tregues ky pozitiv.

Realizimi i programit te shpenzimeve per 4 mujorin I te vitit 2009

nr	Emertimi	2007				2008				2009			
		plan	fakt	ndryshimi	ne %	plan	fakt	ndryshimi	ne %	plan	fakt	ndryshimi	ne %
1	Shpenz.personeli	17,225	16,612	613	96%	19,562	19,631	69	100%	17,376	19,298	(1,922)	111%
2	Kosto e borxhit	8,652	7,963	689	92%	9,427	9,195	-232	98%	11,193	10,708	485	96%
3	Shpenzime operative	5,988	5,780	208	97%	8,114	5,744	-2,370	71%	9,508	7,982	1,526	84%
4	Subvencione	596	745	-149	125%	584	287	-297	49%	587	608	(21)	104%
5	Sigurime shoqerore	22,738	20,919	1,819	92%	23,018	22,642	-376	98%	30,732	28,711	2,021	93%
6	Buxheti Lokal	5,087	4,523	564	89%	7,029	6,105	-924	87%	10,566	8,159	2,407	77%
7	Politika sociale	4,115	3,254	861	79%	4,460	3,707	-753	83%	5,164	4,616	548	89%
8	Komp. ishpronareve	66	0	66	0%	0	0	0	0%	500	-	500	0%
9	Fondi rezerve	780	0	780	0%	1,780	0	-1,780	0%	900	-	900	0%
10	Shpenzime kapitale	15,443	7,654	7,789	50%	17,402	10,377	-7,025	60%	22,987	31,477	(8,490)	137%


(ne milione lek)

Ne se do te flasim per sektoret e percaktuar si prioritare ne dokumentat, situata per 4 mujorin e pare te vitit paraqitet si vijon :

I. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit


Pjesa dermuese e shpenzimeve publike per kete ministri eshte drejtuar ne komponentin e shpenzimeve kapitale dhe vecanerisht ne projektin rrugor per segmentin Rreshen Kalimash. Investimet ne kete 4 mujor, edhe per efekt te funksioneve qe ka ky institucion, zene 95% te totalit te shpenzimeve. Shpenzimet e personelit dhe operativet plotesojne “pamjen”.

Ne rang vendi investimet e kesaj ministrie zene rreth 75% te totalit te shpenzimeve kapitale; 66% e ketyre investimeve i takojne segmentit rrugor te lartepemundur. Me poshte po japim strukturen e shpenzimeve te MPPT per periudhen Janar –Prill 2009




II.Ministria e Arsimit dhe e Shkences

Peshen kryesore te shpenzimeve ne sektorin e arsimit e zene pagat dhe sigurimet shoqerore, fakt ky qe shpjegohet me numrin e madhe te punonjesve ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences. Zeri i pagave dhe sigurimeve shoqerore per kete ministri ze 86% te totalit te shpenzimeve per kete ministri, ndersa shpenzimet operative dhe ato per investime zene respektivisht 6 dhe 8%



III. Ministria e Shendetesise

Duke iu referuar te dhenave te thesarit vihet re se ne shpenzimet e shendetesise per periudhen qe po analizojme, pjesen kryesore e zene shpenzimet operative. Ky perqendrim vjen nga fakti qe ketu jane perqendruar edhe sherbimet qe ofron ky sektor per shendetin publik dhe trajtimin shendetesor te popullise. Shpenzimet operative per kete sektor zene 88%, ndersa shpenzimet per personelin (paga+sigurime shoqerore) perbejne 10% te totalit te shpenzimeve te Ministrise. Shpenzimet kapitale paraqiten si vetem 2% e totalit. Grafiki i strukturave te shpenzimeve te Ministrise se Shendetesise paraqitet si me poshte:



Duke ballafaquar realizimin e programit te investimeve kundrejt planit per keta tre sektore bie ne sy realizimi ne nivele te larta i planit ne MPPTT qe ka realizuar 43% te programit vjetor. Nderkohe qe te dy ministrite e tjera, MASH dhe MSh, jane ne nivele te ulta madje realizimet ne te dy ministrite nuk e kalojne respektivisht vlerat prej 14% dhe 17 % te programeve vjetore te investimeve.

3. Sugjerime dhe rekomandime

Fund viti 2008 por edhe fillim viti 2009 po dëshmojnë për një shtrirje të krizës në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë reale dhe në pothuajse shumë vende të Europës e më gjerë. Procesi i hapjes së tregjeve dhe integrimi ekonomik nuk mund të mos sillte shtrirjen e qëndrueshme të efekteve të krizës edhe tek vendet në zhvillim dhe ekonomitë e tranzicionit.

Edhe vendi ynë mund të thuhet se është përfshirë nga valët që po përhap kjo krizë. Nisur nga zhvillimet e fundit makroekonomike si dhe tendencat e përgjithshme mund të themi se elementet e krizes janë gjithmonë me prezente në ekonominë shqiptare. Rënia e ritmit të rritjes, përkeqësimi i vazhdueshëm i bilancit të eksport importit, ritmete kreditimit të ekonomisë kanë shënuar rënie, por edhe remitancat gjithashtu. Të gjitha sa më sipër së bashku me dobësimin e lekut në raport me monedhën e përbashkët europiane, kanë dhënë kontribut të drejtëpërdrejtë në mosrealizimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit. Ky përfundim është i vërtetë veçanërisht po të analizojmë të ardhurat fiskale. Po ti referohemi të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Akciza, Tatim Fitimi që zënë peshën kryesore të të ardhurave të buxhetit të shtetit, vihet re se nga muaji në muaj thellohet diferenca, përkundrejt objektivave të vendosur në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.

Nga ana tjetër kemi një tejkalim të shpenzimeve publike e veçanërisht shqetësuese është tejkalimi i shpenzimeve për pagat, sigurimet shoqërore e për herë të parë në historinë e këtyre 15 viteve edhe tejkalimi i investimeve. Mos realizimi i të ardhurave nga njëra ana dhe tejkalimi i shpenzimeve buxhetore nga ana tjetër kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në rritjen e tejkalimin e deficit buxhetor përtej objektivave ligjor të përcaktuar në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2009. Për pasojë edhe huamarrja është tejkaluar duke ndikuar në rritjen e kosto së borxhit, e cila do të reflektohet në vitin e ardhshëm fiskal.

Ne mendojmë se duhet

Së pari, një vlerësim realist të situatës nga ana e qeverisë dhe institucioneve vendimmarrëse.

Së dyti, një vëmëndje e posaçme ndaj paralajmërimeve të institucioneve të pavarura lidhur me shpenzimet buxhetore:

Per te vene nen kontroll situaten buxhetore eshte e domosdoshme te ndermerren disa hapa konkrete qe synojne kontrollin e shpenzimeve e per pasoje edhe te deficitit buxhetor. Nisur nga analiza e realizimit te treguesve fiskale vecanerisht te 4 mujorit por dhe te disa treguesve te 5 mujorit si dhe e tendencave te pergjithshme te zhvillimeve makroekonomike do te rekomandonim

- Hartimin e nje buxheti alternativ ku ne fokus të jetë rishikimi dhe rivlerësimi i objektivave, për të ardhurat fiskale e veçanërisht për zërat kryesore të të ardhurave tatimore si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Akcize, Tatim Fitimi. Diferencat e krijuara duhen rivlerësuar dhe rishpërndarë, për pjesën e mbetur të vitit në nivel të administratave fiskale si dhe në strukturat e tyre vartëse.
- Aplikimi i lehtësirave fiskale në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të stimuluar aktivitete dhe bizneset në vështiresi ekonomiko financiare.
- Rishikimi i programit të shpenzimeve publike dhe kontrolli mbi to, pezullim i disa shpenzimeve, vecanerisht shpenzimeve operative, në ato ministri dhe institucione, që kanë dëshmuar dobësi në realizimin e fondeve publike dhe ende nuk kanë filluar procedurat ligjore të prokurimit.

- Rishpërndarja e fondeve publike në ato ministri dhe institucione buxhetore që garantojnë realizmin eficient të fondeve, kanë ecuri të mirë në konkretizimin e procedurave të prokurimit publik dhe kanë aftësi të mira menaxhuese.
- Rishikimi i programit të shpenzimeve publike për investime duke përcaktuar prioritet e nevojshme si dhe duke siguruar financimin e punimeve për investimet e realizuara.

Kontrolli i deficitit buxhetor dhe minimizimi i përdorimit të instrumentit të kredisë direkte për financimin e deficitit buxhetor.